



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2023:200646

Datë: 02.04.2024

Numri i dokumentit: 05532869

P.nr.386A/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, në lëndën penale të akuzuarit B. I. , i akuzuar për veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par 1 të KPRK-së duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.2743/23 të datës 18.12.2023, në seancën e shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 21.03.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Blerim Igrishta i akuzuari B. I. dhe mbrojtësin sipas autorizimit Fanol Krasniqi me datë 26.03.2024 mori, publikisht shpalli, ndërsa me datë 02.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari B. I., i biri i M. dhe nëna E. e gjinisë Sh....., i lindur me, në F. K....., me vendbanim në fshati N..... Rr. P..... I...” KK F. K....., me numër personal, të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datën 01.02.2023, në fshatin B....., komuna e F..... K....., i pandehuri B.... I..... ka përdorë armën me gazë, të llojit “Z.... M...”, me nr. serik, duke shtënë një herë në ajër, të cilën armë me dije e ka mbajtur në pronësi, në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, e cila armë i është konfiskuar të njëjtit gjate një kontrolli nga personat zyrtar, sepse për mbajtjen e armës në fjalë nuk ka poseduar leje valide nga organet kompetente.

- *Me këtë ka kryer veprën penale, Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së.*

Andaj, gjykata në bazë të neneve të lartcekura dhe neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 43, 48, 69, 70, 71, 72, 76, dhe 367 par 1 të KPRK-së dhe neneve 358, 359, 360 dhe 364 të KPPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

DENIM ME KUSHT

- I. Ashtu që dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti i pandehuri nuk do ta mbaj, nëse në periudhë kohore prej 1 (një) viti nuk kryer veprë të re penale.

- II. Konfiskohet arma - e tipit Z. M....-T, Made byy ATAK armsltd Cal 9mm PAK me numër serik Z..... dhe një karikator e sekuestruar nga Policia e Kosovës – Stacioni Policor Fushë Kosovë me numër të rastit 2023-AE-0150 i datës 01.02.2023 dhe urdhërohet që pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi arma e konfiskuar të shkatërrohen nga Policia e Kosovës në bashkëpunim me Prokurorin.
- III. Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 60 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP/II.nr.2743/23 të datës 18.12.2023, ndaj të akuzuarit B. I. për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprat penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 paragrafi 1 të KPRK-së në bashkim real me veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Gjykata në këtë çështje penale ka bërë rikualifikimin e veprës penale pasi që në bazë të përshkrimit të gjendjes faktike si në dispozitiv të aktakuzës rezulton se në veprimet e të pandehuri janë konsumuar elementet e dy veprave penale dhe atë Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 376 par 1 dhe Mbajtje në pronësi kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të KPRK-së, mirëpo duke qenë se prokuroria themelore në Prishtinë të akuzuarin sipas aktit akuzues e akuzon me një pikë me pretendim se kemi bashkim real në mes të veprave penale gjykata e rikualifikon veprën penale vetëm në përdorim të armës apo mjete të rrezikshëm sipas nenit 376 par 1 të KPRK-së pasi vlerëson se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me bashkim real të veprave penal.

Gjykata, në këtë çështje penalo juridike ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 19.03.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Blerim Igrishta dhe të pandehurit B. I. me mbrojtësin sipas autorizimit Fanol Krasniqi ku i njëjti u njoftuan me të drejtat e tij, me aktakuzën dhe provat kundër tij. Pas kësaj prokurori i shtetit lexoj aktakuzën kundër të pandehurit.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i pandehuri u deklarua se e pranojnë fajësinë për veprën penale për të cilat akuzohet sipas aktakuzës.

Pas deklarimit të pandehurit dhe mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, Gjykata konstatoj se i pandehuri ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 të KPPRK-së janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë ne këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të

akuzuarve se e pranojnë fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit B. I. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprat me dashje, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, gjykata ka vlerësuar faktin se i akuzuari ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier i përgjegjshëm për veprimet e tij dhe duke shprehur keqardhje për veprat që e ka kryer e po ashtu edhe faktin se i njëjti nuk kishte qenë ndonjëherë i dënuar për ndonjë veprë penale. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese në dobi të akuzuarit. Rrethana rënduese nuk janë konstatuar nga ana e Gjykatës.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata në kuptim të nenit 48 të KPRK-së të akuzuarin e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen veçanërisht llojin e njëjtit të veprës penale, por ai do të ndikojë edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPPRK-së.

Duke u bazuar në nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPPRK-së si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 €.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 364 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL
P.nr.386A/23 datë 02.04.2024

Gjyqtarja e vetme Gjykuese

Laura Hoti Statovci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.